



AKT - THEMELIMI

PER SHOQERINE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "JOTI" FIER

Ne Fier, sot me date 23 korrik 1997 une - Liu Kostandin Joti, i vitli-
ndjes 1955, banues ne Portez te Fierit, mbeshtetur ne ligjet 7638 date 19.11.1992
"Per shoqerite tregtare" si dhe 7632 date 4.11.1992 "Per dispozitat qe rregullo-
jne pjesen e pare te Kodit Tregtar" nxjerre kete akt - themelimi:

Neni 1

Krijohet shoqeria tregtare, me ortak te vetem Liu Joti, do te jete shoqeri
me pergjegjesi te kufizuar, me emertimin "JOTI" shpk.

Neni 2

Selia dhe qendra e kesaj shpk-je do te jete ne lagjen "1 maj" nr.15, ne
qytetin Fier.

Neni 3

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "Joti" ka statusin e personit juridik
shqiptar dhe veprimtarine e saj do te kryeje ne pajtim me ligjin shqiptar.

Neni 4

Kjo shoqeri krijohet me mjetet financiare te ortakut te vetem Liu Joti, qe
si fillim kap shifren prej 100000 (njqindmije) leke, kapital themeltar.

Neni 5

Objekt i veprimtarise se SHPK "JOTI" Fier do te jete:

1. Tregtim lendesh ndertimi, si : tulla, zhavorr, gure, cakell, cemento etj, brend
dhe jashte vendit.

2. Transport dhe tregtim karburantesh te ndryshme, brenda dhe jashte vendit
(import-export) me shumice dhe pakice.

Neni 6

Organi me i larte drejtues i shpk "Joti" eshte ortak i vetem dhe
njekohesisht administrator i saj Liu Joti.



Neni 7

Shoqeria krijohet per te ushtruar aktivitetin e saj tregtar per nje kohe pezmbi 10 vjet.

Neni 8

Ne vendim te ortakut te vetem shoqeria ne pergjegjesi te kufizuar "JOTI" Fier, mund te pranoje ortakte te tjere, perandrejft kushteve qe do te vendosen ne castin e aderimit.

Neni 9

Po ashtu ne vendim te ortakut te vetem shtohet apo pakesohet objekti i veprimtarise se shoqerise.

Neni 10

Fitimi i nxjexre nga veprimtaria e ligjshme e e shpk "JOTI" eshte e tera per llogari te ortakut te vetem Liu Joti.

Neni 11

Per detyrimet qe shpk mund te ketë ndaj shtetit dhe personave te trete, fizik apo juridike, pergjigjet me mjetet e veta financiare dhe materiale.

Rreziku i humbjeve eshte ne ngarkim te ortakut te vetem.

Neni 12

Per funksionimin normal te shoqerise tregtare ortakut i vetem do te hartoje statutin e shpk "Joti", ku do te parashikohen detyje lidhur ne aktivitetin e saj.

Neni 13

Vula e shoqerise ne pergjegjesi te kufizuar "Joti" do te jete rrethore me ketë pezmbajtje: SHOQERIA NE PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "JOTI" IMP. EXP. FIER ALBANIA.

Neni 14

Veprimtaria e shoqerise ushtrohet ne gjithe territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj.

Neni 15



- 3 -

Shoqëria në përgjegjësi të kufizuar "JOTI" Fier shpërbehet në se
vertetohen rastet e parashikuara në ligjin shqiptar dhe në statutin e saj.

Noni 16

SHPK "JOTI" Fier marrë personalitet juridik në rregjistrimin e saj
në rregjistrin tregtar pranë Gjykatës së rrethit Tiranë. Ky akt themelimi së bash-
ku në statutin e saj deponohen pranë asaj gjykate në një kopje.

THEMBLUESI (ORTAK I VETEM) SHPK "JOTI" FIER

LIU JOTI

REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA E RRETHIT

Nr. 1622... rregj. 419

Tiranë, me 24.7.1997

V E R T E T I M

Ne Tiranë, sot me datë 24.7.1997 para meje noteri u paraqit zoti Liu

Kostandina Joti, banues në Portez të Fierit, në kombësi e shtetësi shqiptare, në
zotësi të plote juridike për të vepruar, njohur në letërnjoftim personal. Deklaroi
se kete akt themelimi e ka bere me vullnetin e tij te lire dhe e nenshkruan ne
pranine time, une noteri e vertetoj rregullisht sipas ligjit.

NOTERI

.....



NOTERE
ELIDA MAGANI

Relj

STATUT

PER SHOQERINE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "JOTI" FIER



Mbeshtetur ne ligjin 7632 date 4.11.1992 "Per dispozitat qe rregullojne pjesen e pare te Kodit Tregtar" dhe ligjin 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" si dhe ne kontraten e themelimit date 23.7.1997, une Liu Kostandin Joti, banues ne Portez te Fierit, si themelues dhe ortak i vetem i shpk, hartoj kete statut:

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Shoqeria tregtare eshte me pergjegjesi te kufizuar, me statusin e personit juridik shqiptar.

Neni 2

Emertimi i kesaj shoqerie eshte "JOTI" SHPK, e krijuar me kontraten e themelimit date 23.7.1997 te ortakut te vetem Liu Joti, me mjetet e tij financiare.

Neni 3

Qendra dhe selia e shpk "Joti" eshte ne lagjen "1 maj" nr.15 ne qytetin e Fierit. Ajo ka te drejte te cele filiale ne gjithe territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj, duke respektuar ligjin e shtetit perkates.

Neni 4

Vula e saj eshte rrethore me kete permbajtje: SHOQERIA ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "JOTI" IMP. EXP. FIER ALBANIA.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Neni 5

SHPK "JOTI" ka per objekt te veprimtarise se saj:

a. Tregtim lendesh ndertimi si: tulla, zhavorr, gure, cakell, cemento etj, brenda e jashte vendit.

2. Transport dhe tregtim karburantesh te ndryshme, brenda dhe jashte vendit, (import-export) me shumice dhe pakice.

Neni 6

Objekti i veprimtarise se shpk "JOTI" shtohet apo pakesohet ne vendin te ortakut te vetem.

MJETET E S H P K

Neni 7

Shpk "Joti" per fillimin e veprimtarise se saj ka nje kapital prej 100.00 (njegjindmije) leke, prane e ortakut te vetem Liu Joti.

Neni 8

Ne njete te shpk "Joti" kaptohen edhe ato objekte, sende dhe te holla qe fitohen ne te ardhmen nga ushtrimi i veprimtarise se saj.

Neni 9

Per te garantuar shtetin e detyrimeve ndaj shtetit e personave te trete, finlike e juridike, si dhe per te shtuar veprimtarine e vet, shpk "Joti" krijon nje fond reserve qe kap 1/20 e fitimit te vitit paraardhes financiar.

ORGANET DREJTUESE TE S H P K

Neni 10

Organi i vetem drejtues, operativ urdherdhenes dhe vendimor eshte ortak i vetem, njekohesisht administrator i shoqerise Liu Kostandin Joti.

Neni 11

Ortaku i vetem dhe njekohesisht administrator i shpk "JOTI" ka keto kompetenca kryesore:

1. Ndryshimin e selise se SHPK
2. Ndryshimin e emertimit te saj.
3. Vendos per krijimin dhe mbylljen e filialeve te SHPK.
4. Cakton pagat e punonjesve te shoqerise teregjare.
5. Ne se administrator i shpk do te vendoset nje person jo ortak , e emeron dhe shkarkon vete.
6. Ushtron gjithë kompetencat e tjera qe parashikohen ne nene te vecan te ketij statuti, aktin e themelimit e akte te tjera te nevojshme, duke pasur te drete qe tua delegoj ne shkrim dhe punonjesve te tjere te shpk.

Neni 12

Administratori(ortaku i vetem) kur largohet perkohesisht vendos me shkrim zevendesin e tij duke percaktuar konkretisht detyrimet dhe kompetencat qe mban ai per ate periudhe.Zevendesuesi i tij nuk ka te drejte te dale jashte ketyre tagrave.

FITIMI DHE NDARJA E TIJ

Neni 13

Pasi paguhen detyrimet si taksa,tatime,shpenzime te tjera te domosdoshme per veprimtarine tregtare,pagat etj ngelet fitimi neto i shoqerise,qe eshte per llogari te ortakut te vetem.

Neni 14

Me vendimin e ortakut te vetem nga fitimi i realizuar ndahen stimuj per punonjesit e shpk "Joti".

Ortaku i vetem mbart mbi vehte rrezikun e falimentimit deri ne masen 100 perqind te kapitalit themeltar dhe atij rezerve.

Neni 15

Shoqeria tregtare "Joti" mund te kaloj nga shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne shoqeri me pergjegjesi te pakufizuar,ne se fitimet do ti kete te bollshme.Per kete vendos ortakut i vetem.

ORGANIZIMI I PERDITSEM

Neni 16

Me qellim qe te zhvilloj normalisht veprimtarine e vet shoqeria ndahet ne njesi te vogla,lehtesisht te manovrueshme,cfare e percakton ortakut i vetem.

Neni 17

Me vendim te ortakut te vetem neper qytete te tjera te Shqiperise shoqeria mund te krijoj filialet e veta,me ose pa pavaresi buxhetore,sic e cakton organi vendimor.

MARRËDHENIET E PUNES NE SHPK

Neni 18

Ne shpk "Joti" mund te futen ortake te rinj ne kushtet e percaktuara ne kontraten perkatese qe behet me kete rast.

Neni 19

Per punonjesit e tjere te shoqerise behen kontrata kolektive dhe individuale te punes.

Neni 20

Punonjesi i shoqerise pergjigjet disiplinarisht, materialisht dhe penalisht ne se eshte rasti, kur shkelen detyrimet e kontrates se punes, per demet qe mund t'i shkaktoj shpk me veprimet apo mosveprimet e tij te fajshme.

KOHEZGJATJA DHE MBYLLJA E SHPK

Neni 21

SHPK "JOTI" krijohet per nje veprimtari me afat permby 10 vjet.

Neni 22

Ajo mbyllet ne rastet kur veprimtaria e saj eshte ne kundërshtim me ligjin shqiptar dhe kur hapen procedurat e falimentimit ndaj saj.

DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 23

SHPK "JOTI" Fier fiton zotesine per te vepruar si person juridik me rregjistrimin ne Gjykatën e rrethit Tirane ne rregjistrin tregtar.

Nje kopje e ketij statuti dhe e aktit te themelimit si dhe kerkesa perkatese depozitohen prane kesaj gjykate.

THEMELJESI I SHPK "JOTI" FIER

BIU JOTI

